



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË KULTURËS
DREJTORIA E POLITIKAVE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Nr. 15429/2 Prot.

Tiranë, më 03. 2. 2025

Lënda: Përcillet urdhëri “Për ngritjen e Komisionit Këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme”

INSTITUTIT KOMBËTAR TË REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Në vijim të korrespondencës suaj nr. 240/6, datë 13.01.2025 “Mbi listën e kandidatëve për “Ekspert vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme”, protokolluar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 446, datë 15.01.2025, ju dërgojmë bashkëlidhur urdhërin e Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr. 77, datë 23.01.2025 “Për ngritjen e Komisionit Këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e paluajtshme”, për njohje dhe zbatim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

LLAMBRIOLA MISTO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 15429/prot.

2

Tiranë, më 23/1. 2025

URDHËR
Nr. 77 datë 23.1 2025

PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR VLERËSIMIN DHE IDENTIFIKIMIN
E VLERAVE KULTURORE NË PASURITË E LUAJTSHME

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59 të Ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 666, datë 23.10.2023 “Për mënyrën e funksionimit të komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale”, në vijim të shkresës së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore nr. 240/6, datë 13.01.2025 “Mbi listën e kandidatëve për “Ekspert vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme”, protokolluar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 446, datë 15.01.2025,

URDHËROJ:

1. Ngritjen pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, të Komisionit Këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, me përbërjen si vijon:
 - a) Silvana Nini
 - b) Dorina Arapi
 - c) Iris Pojani
 - d) Esmeralda Agolli
 - e) Edlira Çaushti
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Komisioni Këshillimor sipas pikës 1 për zbatimin e këtij Urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Zhvillimin e Kulturës për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Blendi GONXHJA

